**VENDIM**
**Nr. 478, datë 1.8.2023**

# PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 205, DATË 6.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE TË APLIKIMIT, TË RREGULLAVE TË KRYERJES SË VERIFIKIMEVE DHE KONTROLLEVE TË NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE PËR KONTRIBUT TË VEÇANTË NË FUSHËN E ARSIMIT, SHKENCËS DHE SPORTIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 205, datë 6.4.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave të aplikimit, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare për kontribut të veçantë në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën "e", të kreut I, pas togfjalëshit "... ministria përgjegjëse ..." shtohen fjalët "... për arsimin, shkencën dhe sportin në Republikën e Shqipërisë ...".

2. Në kreun II bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në shkronjën "e", pas emërtimit "... Republikën e Shqipërisë ..." shtohen fjalët "... që përkojnë me standardin e minimumit jetik, të indeksuar çdo vit në lidhje me indeksin e çmimeve të disa mallrave të zgjedhura, të parashikuar në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore ...".

b) Shkronja "ë" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"ë) ka kontribut të veçantë në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit, të njohur ndërkombëtarisht ose ka arritur rezultate të larta në arenën ndërkombëtare, sipas disiplinës që përfaqëson.".

3. Në pikën 1, të kreut IV, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja "ç" shfuqizohet.

b) Shkronja "dh" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"dh) Vetëdeklarim se nuk ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë në shtetin e origjinës, në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet të tretë për vepra penale, për të cilat ligji shqiptar parashikon dënime jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie. Vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore i bashkëlidhet formularit të kërkesës për fitimin e shtetësisë, të miratuar nga AHPVSH-ja.".

c) Në shkronjën "e", fjala "... zyrtare ..." hiqet.

ç) Në shkronjën "f", fjala "... vërtetuar ..." zëvendësohet me "... lëshuar ...".

d) Në shkronjën "g" bëhen këto ndryshime:

i. Nënparagrafi "i" shfuqizohet.

ii. Nënparagrafët "ii" dhe "iii" ndryshohen, si më poshtë vijon:

"ii. 1 (një) rekomandim nga një institucion përkatës në fushën e arsimit, shkencës, sportit dhe federatat sportive në Republikën e Shqipërisë, në varësi të disiplinës;

iii. 2 (dy) rekomandime nga personalitete të fushës së sportit apo klubet sportive ku kanë luajtur, të vendit të origjinës dhe/ose të shtetit shqiptar, në disiplinën përkatëse për të cilën individi kërkon të fitojë shtetësinë shqiptare.".

II. Kërkesat e depozituara në AHPVSH, jo më vonë se 5 (pesë) muaj përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të shqyrtohen në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.

III. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministri përgjegjës për arsimin, shkencën dhe sportin dhe Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**